



# Child Health Plus

## Në një vështrim të shpejtë

### KUSH KUALIFIKOHET?

#### FËMIJËT QË:

- Janë nën 19 vjeç
- Janë banorë të New York State
- Nuk kualifikohen për "Medicaid"
- Nuk mbulohen nga sigurime të tjera shëndetësore
- Nuk kualifikohen apo nuk janë të regjistruar në mbulimin shëndetësor nëpërmjet një programi shtetëror të përfitimeve shëndetësore (NYSHIP)
- Fëmijët mund të kualifikohen pavarësisht statusit të emigracionit

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, besimit/fesë, gjinisë, moshës, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.

### ÇFARË MBULOHET?

- Vizita normale për fëmijë
- Ekzaminime fizike
- Vaksinime
- Shërbime laboratorike dhe imazherie
- Shërbime emergjence
- Barna me recetë
- Barna pa recetë, nëse porositen nga mjeku
- Shtrim në spital
- Shërbime afatshkurtra teraupetike për pacientët e jashtëm (kimioterapi, hemodializë)
- Shërbime të çrregullimeve të shëndetit mendor dhe të abuzimit me substancat për pacientë të shtruar dhe të jashtëm
- Shërbime dentare dhe okulistike
- Shërbime për të folurin dhe të dëgjuarin
- Pajisje mjekësore për përdorim afatgjatë
- Shërbim kujdesi paliativ

#### NA KONTAKTONI:

[nystateofhealth.ny.gov](http://nystateofhealth.ny.gov) | 1-855-355-5777 ose TTY 1-800-662-1220

## SA KUSHTON PLANI CHILD HEALTH PLUS?

**PRIMET MUJORE:** Çmimi mujor varet nga të ardhurat familjare dhe nga madhësia e familjes.\* Nuk ka prime mujore për familje me të ardhura më të ulëta. Familjet me të ardhura më të larta paguajnë një prim mujor sipas grafikut të mëposhtëm. Për familje më të mëdha, tarifa mujore kufizohet në deri tre fëmijë. Familjet me të ardhura mbi nivelin për mbulim të subvencionuar mund të paguajnë primin e plotë që luhatet sipas pjesëmarrjes në planin shëndetësor.

**NDARJA E KOSTOVE:** "Child Health Plus" nuk ka zbritje vjetore dhe forma bashkëpagimi.

Të ardhurat maksimale vjetore sipas madhësisë së familjes				Kontributi mujor familjar për fëmijë (numri maks. i fëmijëve për të cilët paguani është 3)
1	2	3	4	
më pak se \$20,608	më pak se \$27,872	më pak se \$35,136	më pak se \$42,400	\$0
\$28,594	\$38,673	\$48,752	\$58,830	\$9 (maks. \$27)
\$32,200	\$43,550	\$54,900	\$66,250	\$15 (maks. \$45)
\$38,640	\$52,260	\$65,880	\$79,500	\$30 (maks. \$90)
\$45,080	\$60,970	\$76,860	\$92,750	\$45 (maks. \$90)
\$51,520	\$69,680	\$87,840	\$106,000	\$60 (maks. \$180)
mbi \$51,520	mbi \$69,680	mbi \$87,840	mbi \$106,000	Prim i plotë, ndryshon sipas planit shëndetësor (nuk ka një vlerë maksimale për familjarët)

\*Bazuar në nivelet federale të varfërisë (FLP) të vitit 2021. Nivelet e të ardhurave mund të ndryshojnë çdo vit sipas ndryshimeve të FPL-së.